

Treguesit e realizimit të
buxhetit të Bashkisë Tiranë
për 8-mujorin 2022

]

	HYRJE	Fq.3
KAPITULLI I	Realizimi i shpenzimeve të Bashkisë Tiranë për 8 mujorin 2022	Fq.4
	Shpenzimet sipas programeve	Fq.6
	Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fq.7
	Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik	Fq.8
KAPITULLI II	Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve	Fq.14
KAPITULLI III	Ecuria e buxhetit të Bashkisë Tiranë për 8 mujorin e viteve 2018- 2022	Fq.52

RAPORT MONITORIMI
I
BASHKISË TIRANË PËR 8-MUJORIN 2022

HYRJE

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), ligjit nr. 68 datë 27.04.2017 “ Për Financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”; Udhëzimit nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 166 datë 24.12.2021 ‘Për miratimin e PBA 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022, (i ndryshuar), paraqesim raportin e monitorimit të buxhetit për 8-mujorin 2022, duke analizuar performancën financiare në funksion të arritjes së objektivave dhe realizimit të shpenzimeve sipas programeve.

Raporti bazohet në të dhënat për shpenzimet faktike dhe transfertat ndërqeveritare, duke ndjekur klasifikimin administrativ, ekonomik, funksional dhe sipas burimeve të financimit.

Transparenca mbi përdorimin e fondeve publike është e rëndësishme për përmirësimin e ofritit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Tashmë që nga viti 2015 zbatohet Reforma Administrative dhe Territoriale (RAT) dhe e decentralizimit të funksioneve të reja.

Në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë’, me VKB nr. 18 datë 04.04.2022 të ardhurat e papërdorura të vitit Buxhetor 2021 trashëgohen në buxhetin e vitit 2022.

Informacioni i përcjellë në këtë raportim është realizat jo vetëm nga raportet e tërhequra nga SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) por dhe nga informacioni i përcjellë në mënyrë shkresore nga Drejtoritë e Bashkisë Tiranë dhe Institucionet e Varësisë të përfshira në këtë proces.

Bashkia Tiranë po vijon me likuidimet e angazhimeve të marra dhe ka vijuar evidentimin dhe përfshirjen në buxhet të detyrimeve të prapambetura nga viti 2021 sipas informacioneve të sjella edhe nga strukturat të cilat menaxhojnë funksionet e Bashkisë.

Nga ana tjetër dinamika me të cilën ecin punët në Bashkinë Tiranë kërkon jo vetëm rishikime të projekteve në vazhdim, por edhe kërkesa për të shtuar projekte dhe shpenzime të reja për të maksimizuar nevojat e Institucionit në funksion të qytetit.

KAPITULLI I

REALIZIMI

I

SHPENZIMEVE TË BASHKISË TIRANË PËR 8-MUJORIN 2022

Bashkia Tiranë gjatë kësaj periudhe, ka menaxhuar dhe realizuar shpenzime sipas 34 programeve buxhetore, Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës, bazuar në funksionet bazë dhe të deleguara sipas ligjit për qeverisjen vendore, konkretisht:

1. Programi Planifikim, Menaxhim & Administrim
2. Programi Çështje Financiare & Fiskale
3. Programi Gjendja Civile
4. Programi Shërbimet e Policisë Vendore
5. Programi Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile
6. Programi Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik
7. Programi Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi
8. Programi Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve
9. Programi Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit
10. Programi Administrimi i Pyjeve & Kullotave
11. Programi Rrjeti Rrugor
12. Programi Transporti Publik
13. Programi Projekte Zhvillimi
14. Programi Zhvillimi i Turizmit
15. Programi Menaxhim i Mbetjeve
16. Programi Programet e Mbrojtjes së Mjedisit
17. Programi Planifikim Urban Vendor
18. Programi Strehimi
19. Programi Programet e Zhvillimit
20. Programi Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
21. Programi Shërbimet Publike Vendore
22. Programi Ndriçim Rrugësh
23. Programi Sport dhe Argëtim
24. Programi Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore
25. Programi Arti dhe Kultura
26. Programi Arsimit Bazë përfshirë arsimin parashkollor
27. Programi Arsimit i Mesëm i Përgjithshëm
28. Programi Arsimit Profesional
29. Programi Arsimit Universitar
30. Programi Kujdesi Social për personat e sëmurë & me aftësi të kufizuara
31. Programi Kujdesi Social për familjet & fëmijët
32. Programi Papunësia, Arsim & Aftësim Profesional
33. Programi Strehim Social
34. Programi Emergjencia Civile
35. Fondi Rezervë

36. Fondi i Kontigjencës

Buxheti fillestar i Bashkisë Tiranë për vitin 2022 është 23,608,964,061 lekë. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale dhe Donatorët.

Gjatë vitit 2022 kemi pasur rishikim të buxhetit me 8 (tetë) vendime të Këshillit Bashkiak dhe 3 (tre) Urdhëra Kryetari.

Referuar Akt-rakordimeve përfundimtare, fondi i mbartur në total është në vlerën 5,274,288,403 lekë i përbërë: nga të ardhurat e mbartura dhe të papërdorura 3,606,092,031 lekë; nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e përgjithshme në shumën 1,643,211,738 lekë dhe nga donatorët në shumën 24,984,634 lekë.


Referuar Akt-rakordimit përfundimtar të fondit të rindërtimit vlera e mbartur është 5,349,010,561 lekë.

1. Çështje të rishpërndarjes së buxhetit gjatë periudhës

- Përfshirja e kërkesave dhe e detyrimeve të krijuara rishtazi në buxhetin e vitit 2022, për Aparatin e Bashkisë si dhe për të gjitha institucionet e varësisë së Bashkisë së Tiranës, si dhe sistemime në zërat e investimeve duke sjellë si rezultat shtesa, pakësime apo rishpërndarje fondesh si rezultat i dinamikës pas hapjes nga periudha e pandemisë.
- Fondet e trashëguara të rindërtimit nga viti 2021 përdoren për të njëjtin qëllim për të cilin janë akorduar bazuar në VKM-të e vitit 2022 si rindërtimi i objekteve arsimore, rindërtimi i banesave individuale, rindërtimi i infrastrukturës publike, rindërtimi i njësive të banimit ndërtesa (pallat) zona 5 Maji Kombinat, hartim i planeve të detajuara vendore, inspektim vlerësim dëmsh, hartim projekti të ndërhyrjeve rehabilituese si dhe Shpronësim Zhvillimi i Njësive Administrative Vaqarr dhe Zall-Herr.
- Nga Drejtoritë e Përgjithshme janë paraqitur kërkesa për rialokime në buxhetin e vitit 2022 kryesisht në shtim plani për shpenzime operative, ndryshime emërtimesh, investime të reja, studim projekte dhe oponenca për objekte të reja ndërtimore etj.
- Fond shtesë për rindërtimin për vitin 2022, akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rforcimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkinë Tiranë.
- Mbështetje financiare në kuadër të aktivitetit ndërkombëtar Europa Conference League Final për Federatën Shqiptare të Futbollit.

2. Shpenzimet sipas programeve

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 i Bashkisë Tiranë i ndarë sipas programeve paraqitet si vijon:



Siç vihet re, peshën më të madhe në planifikim e zënë:

- Programi i Shërbimeve Publike Vendore (13%)
- Programi i Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor (11%)
- Programi i Panifikimit Urban Vendor (10%)
- Programi i Rrjetit Rrugor (8%)
- Programi i Planifikim, Menaxhim dhe Administrimit (8%)
- Programet e Zhvillimit (7%)
- Programi Kujdesit Social per familjet dhe fëmijët (6%)
- Programi i Menaxhimit të Mbetjeve (5%)
- Programi Arsimi i mesëm i përgjithshëm (5%)
- Programet e Tjera (26%)

3. Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Në total Bashkia Tiranë ka një realizim prej 47% të planit 8-mujor 2022. Kjo vlerë përfshin të gjitha burimet e financimit.

Referuar klasifikimit ekonomik realizimi paraqitet si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar me 85%,
- Shpenzimet operative me 61% dhe
- Shpenzimet kapitale me 27%.

Më poshtë paraqitet në mënyrë tabelare informacioni i mësipërm:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	në lekë	
				Realizimi në %	
<i>Shpenzime personeli</i>	6,976,383,468	4,663,342,062	3,964,414,249	85%	
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	13,705,606,486	11,368,178,823	6,909,167,178	61%	
<i>Shpenzime kapitale</i>	20,225,561,695	16,703,070,394	4,532,178,648	27%	
Totali	40,907,551,649	32,734,591,279	15,405,760,075	47%	


4. Shpenzimet sipas burimeve të financimit

Shpenzimet sipas burimeve të financimit për 8-mujor 2022, paraqiten si më poshtë:

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %	në lekë
					struktura vjetore
<i>Të ardhura BT</i>	23,394,641,168	16,655,243,327	7,191,260,927	43%	57%
<i>Transferta e Pakushtëzuar +Sektoriale</i>	5,436,099,538	4,453,771,305	2,742,741,705	62%	13%
<i>Transferta e Pakushtëzuar Rindërtimi</i>	6,143,090,980	6,143,090,980	2,770,761,039	45%	15%
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	5,720,265,584	5,288,132,909	2,694,827,492	51%	14%
<i>Donacione</i>	35,621,395	16,519,774	3,296,711	20%	0%
<i>Financime të Huaja</i>	159,129,121	159,129,121	-	0%	0%
<i>TVSH Detyrimi</i>	18,703,863	18,703,863	2,872,201	15%	0%
Totali	40,907,551,649	32,734,591,279	15,405,760,075	47%	100%

Sikurse vërehet edhe në tabelën e mësipërme, burimi kryesor i financimit për buxhetin 8-mujor 2022 vijon të jetë nga të ardhurat e Bashkisë, në vlerën faktike 7,191,260,927 lekë e cila përbën 43% të të ardhurave totale faktike. Fondet e Pakushtëzuara dhe Sektoriale zënë 13% të burimeve të financimit të planifikuara, Fondet e Pakushtëzuara Rindërtimi zënë 15% të burimeve të financimit të planifikuara.

Fondet e Kushtëzuara zënë 14% të strukturës së burimeve të financimit, sipas grafikut më poshtë:



5. Shpenzimet sipas klasifikimit në programe

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e shpenzimeve të 8-mujorit 2022 në bazë programesh:

në lekë

	Emërtimi	Plan 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	% ndaj planit 8M	struktura/plani vjetor
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	3,148,711,669	2,249,615,355	1,574,486,253	50%	8%
01120	Çështje Financiare & Fiskale	350,990,358	239,000,000	180,757,797	51%	1%
01170	Gjendja Civile	46,780,675	35,129,000	34,484,376	74%	0%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	621,964,339	422,520,000	332,060,932	53%	2%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	1,251,741,916	1,180,994,977	281,821,703	23%	3%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	43,090,000	41,666,000	11,767,473	27%	0%
04160	Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi	69,404,498	49,230,520	41,941,145	60%	0%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	287,875,879	199,116,214	129,505,019	45%	1%
04240	Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit	119,460,471	114,509,126	14,933,138	13%	0%
04260	Administrimi i Pyjeve & Kullotave	11,758,002	9,480,284	6,464,500	55%	0%

04520	<i>Rrjeti Rrugor</i>	3,378,016,249	2,474,137,088	740,956,186	22%	8%
04570	<i>Transporti Publik</i>	588,657,585	514,337,811	196,028,070	33%	1%
04740	<i>Projekte Zhvillimi</i>	484,128,656	391,795,136	87,863,530	18%	1%
04760	<i>Zhvillimi i Turizmit</i>	20,152,950	16,152,950	11,508,550	57%	0%
05100	<i>Menaxhim i Mbetjeve</i>	2,085,858,518	1,738,698,518	1,396,242,687	67%	5%
05320	<i>Programet e mbrojtjes së mjedisit</i>	9,837,947	7,837,947	3,782,296	38%	0%
06140	<i>Planifikim Urban Vendor</i>	3,972,725,085	3,437,616,083	830,537,137	21%	10%
06190	<i>Strehimi</i>	400,301,000	400,301,000	199,910,000	50%	1%
06210	<i>Programet e Zhvillimit</i>	2,909,931,608	2,903,931,608	1,831,361,321	63%	7%
06220	<i>Menaxhimi i mbetjeve urbane</i>	180,000,000	180,000,000	179,722,265	100%	0%
06260	<i>Shërbimet Publike Vendore</i>	5,382,112,026	3,780,886,718	1,125,331,689	21%	13%
06440	<i>Ndriçim Rrugësh</i>	384,867,082	330,867,082	174,202,031	45%	1%
08130	<i>Sport dhe Argëtim</i>	461,403,243	392,369,165	269,945,944	59%	1%
08220	<i>Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore</i>	731,712,239	641,395,056	408,115,841	56%	2%
08230	<i>Arti dhe Kultura</i>	1,754,597,000	1,754,597,000	286,388,216	16%	4%
09120	<i>Arsimi baze përfshirë arsimin parashkollor</i>	4,525,952,270	3,807,034,140	1,816,414,257	40%	11%
09230	<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	2,007,468,077	1,588,045,534	1,038,754,253	52%	5%
09240	<i>Arsimi profesional</i>	198,428,249	168,786,528	76,035,773	38%	0%
09450	<i>Arsimi Universitar</i>	500,000,000	500,000,000	-	0%	0%
10140	<i>Kujdesi Social për personat e sëmurë & me aftësi të kufizuar</i>	17,070,000	12,000,000	1,582,350	9%	0%
10430	<i>Kujdesi Social për familjet & fëmijët</i>	2,517,932,418	2,024,765,983	1,841,005,526	73%	6%
10550	<i>Papunësia, Arsim & Aftësim profesional</i>	35,000,000	35,000,000	14,150,000	40%	0%
10661	<i>Strehimi Social</i>	1,442,646,390	355,799,206	267,699,817	19%	4%
10910	<i>Emergjencë Civile</i>	333,158,750	333,158,750	-	0%	1%
04910	<i>Fondi Rezervë</i>	393,816,500	238,816,500	-	0%	1%
04940	<i>Fondi i Kontigjencës</i>	240,000,000	165,000,000	-	0%	1%
	TOTAL	40,907,551,649	32,734,591,279	15,405,760,075	38%	100%

-Programi Arsim Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor i cili përbën 11% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 40% të 8-mujorit 2022.

- Programet e Zhvillimit i cili përbën 7% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 63% të 8-mujorit 2022.

- Programi i Shërbimeve Publike Vendore i cili përbën 13% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 21% të 8-mujorit 2022.

-Programi i Planifikimit Urban Vendor i cili përbën 10% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 21% të 8-mujorit 2022.

-Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim i cili përbën 8% të buxhetit vjetor dhe është realizuar në masën 50% të 8-mujorit 2022.

6. Shpenzimet sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik

Shpenzimet korente dhe kapitale për çdo funksion sipas programeve dhe nga të gjitha burimet pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

në lekë

	Emërtimi	SHPENZIME KORENTE			SHPENZIME KAPITALE		
		Plan 8M 2022	Fakti 8M 2022	%	Plan 8M 2022	Fakti 8M 2022	%
01110	Planifikim, Menaxhim & Administrim	2,837,307,587	1,490,927,653	53%	311,404,082	83,558,600	27%
01120	Çështje Financiare & Fiskale	312,399,332	180,757,797	58%	38,591,026		0%
01170	Gjendja Civile	46,780,675	34,484,376	74%	-	-	0%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	575,244,339	329,482,993	57%	46,720,000	2,577,939	6%
03280	Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile	1,050,357,581	278,245,507	26%	201,384,335	3,576,196	2%
04130	Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik	43,090,000	11,767,473	27%	-	-	-
04160	Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi	64,220,658	41,576,777	65%	5,183,840	364,368	7%
04220	Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatorëve	266,948,079	129,505,019	49%	20,927,800		0%
04240	Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit	24,181,178	14,933,138	62%	95,279,293		0%
04260	Administrimi i Pyjeve & Kullotave	11,758,002	6,464,500	55%	-	-	-
04520	Rrjeti Rrugor	1,014,998,193	472,812,332	47%	2,363,018,056	268,143,854	11%
04570	Transporti Publik	362,819,774	144,506,864	40%	225,837,811	51,521,206	23%
04740	Projekte Zhvillimi	44,256,317	26,810,647	61%	439,872,339	61,052,883	14%
04760	Zhvillimi i Turizmit	20,152,950	11,508,550	57%	-	-	-
05100	Menaxhim i Mbetjeve	2,085,858,518	1,396,242,687	67%	-	-	-
05320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	9,837,947	3,782,296	38%	-	-	-
06140	Planifikim Urban Vendor	205,293,500	103,647,208	50%	3,767,431,585	726,889,929	19%
06190	Strehimi	400,301,000	199,910,000	50%	-	-	0%
06210	Programet e Zhvillimit	84,165,715	38,508,941	46%	2,825,765,893	1,792,852,380	63%
06220	Menaxhimi i mbetjeve urbane	180,000,000	179,722,265	99%	-	-	-
06260	Shërbimet Publike Vendore	1,409,491,864	733,263,157	52%	3,972,620,162	392,068,532	10%
06440	Ndriçim Rrugësh	384,867,082	174,202,031	45%	-	-	0%
08130	Sport dhe Argëtim	434,687,645	259,406,849	60%	26,715,598	10,539,095	39%
08220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore	635,601,683	405,003,281	64%	96,110,556	3,112,560	3%

08230	<i>Arti dhe Kultura</i>	700,000,000	187,232,243	0%	1,054,597,000	99,155,973	9%
09120	<i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	2,231,512,983	1,181,628,793	53%	2,294,439,287	634,785,464	28%
09230	<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	1,212,020,238	643,041,768	53%	795,447,839	395,712,485	50%
09240	<i>Arsimi profesional</i>	148,158,699	74,122,973	50%	50,269,550	1,912,800	4%
09450	<i>Arsimi Urniversitar</i>			-	500,000,000	-	0%
10140	<i>Kujdesi Social për personat e sëmure & me aftësi të kufizuara</i>	17,070,000	1,582,350	9%	-	-	-
10430	<i>Kujdesi Social për familjet & fëmijët</i>	2,510,833,959	1,836,651,142	73%	7,098,459	4,354,384	61%
10550	<i>Papunësia, Arsim & Aftësim profesional</i>	35,000,000	14,150,000	40%	-	-	-
10661	<i>Strehimi Social</i>	355,799,206	267,699,817	75%	1,086,847,184		0%
10910	<i>Emergjencia Civile</i>	333,158,750	-	0%	-	-	-
04910	<i>Fondi Rezervë</i>	393,816,500	-	0%	-	-	-
04940	<i>Fondi i Kontigjencës</i>	240,000,000	-	0%	-	-	-
	TOTAL	20,681,989,954	10,873,581,427	53%	20,225,561,695	4,532,178,648	22%

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat duke iu referuar Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2022-2024 të miratuar me VKB nr. 166 datë 24.12.2021 dhe në vazhdim, planit për buxhetin vjetor të miratua me këtë vendim, si dhe për këtë periudhë 8-mujori 2022 planin dhe faktin. Kjo vlerë përfshin të Ardhurat e veta të Bashkisë Tiranë, Donatorët, TVSH Detyrime, Transfertën e Pakushtëzuar e Përgjithshme dhe Sektoriale.

në lekë

Emërtimi	PBA fillestar 2022	Plan i rishikuar 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022
<i>Planifikim, Menaxhim & Administrim</i>	2,847,771,753	3,118,334,915	2,219,238,601	1,574,486,253
<i>Çështje Financiare & Fiskale</i>	353,136,358	350,990,358	239,000,000	180,757,797
<i>Shërbimet e Policisë Vendore</i>	517,064,339	621,964,339	422,520,000	332,060,932
<i>Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile</i>	335,276,174	528,589,041	457,842,102	99,052,411
<i>Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik</i>	39,000,000	39,000,000	39,000,000	9,852,337
<i>Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi</i>	69,407,918	69,404,498	49,230,520	41,941,145
<i>Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore & Mbrojtja e Konsumatoreve</i>	275,418,079	287,875,879	199,116,214	129,505,019
<i>Menaxhim i Infrastrukturës së Ujitjes & Kullimit</i>	22,506,113	119,460,471	114,509,126	14,933,138
<i>Administrimi i Pyjeve & Kullotave</i>	10,353,262	11,758,002	9,480,284	6,464,500
<i>Rrjeti Rrugor</i>	2,694,617,454	3,378,016,249	2,474,137,088	740,956,186
<i>Transporti Publik</i>	556,607,185	588,657,585	514,337,811	196,028,070
<i>Projekte Zhvillimi</i>	262,883,520	324,999,535	232,666,015	87,863,530
<i>Zhvillimi i Turizmit</i>	15,000,000	20,152,950	16,152,950	11,508,550
<i>Menaxhim i Mbetjeve</i>	2,028,000,000	2,085,858,518	1,738,698,518	1,396,242,687
<i>Programet e mbrojtjes së mjedisit</i>	9,837,945	9,837,947	7,837,947	3,782,296

<i>Planifikim Urban Vendor</i>	2,535,648,703	3,307,523,892	2,772,414,890	632,185,473
<i>Programet e Zhvillimit</i>	170,000,000	184,165,715	178,165,715	138,508,941
<i>Shërbimet Publike Vendore</i>	4,465,663,798	4,955,543,029	3,354,317,721	946,004,869
<i>Ndriçim Rrugësh</i>	348,666,000	384,867,082	330,867,082	174,202,031
<i>Sport dhe Argëtim</i>	376,317,457	461,403,243	392,369,165	269,945,944
<i>Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike & Kulturore</i>	557,440,618	731,712,239	641,395,056	408,115,841.2
<i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	2,750,627,688	2,890,309,657	2,171,391,527	1,227,298,996
<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	1,514,640,263	1,806,255,267	1,386,832,724	863,298,809
<i>Arsimi profesional</i>	131,835,553	178,681,304	149,039,583	62,784,751
<i>Kujdesi Social për personat e sëmurë & me aftësi të kufizuar</i>	17,070,000	17,070,000	12,000,000	1,582,350
<i>Kujdesi Social për familjet & fëmijët</i>	297,373,881	301,171,359	227,061,924	108,958,871
<i>Papunësia, Arsim & Aftësim profesional</i>	25,000,000	35,000,000	35,000,000	14,150,000
<i>Strehimi Social</i>	191,800,000	1,442,646,390	355,799,206	267,699,817.4
<i>Fondi Rezervë</i>	150,000,000	393,816,500	238,816,500	-
<i>Fondi i Kontigjencës</i>	40,000,000	240,000,000	165,000,000	-
TOTAL	23,608,964,061	28,885,065,964	21,144,238,269	9,940,171,544

Në tabelën më poshtë paraqiten fonde të transferuara gjatë kësaj periudhe për Bashkinë Tiranë si rezultat i funksioneve të deleguara për këtë periudhë 8-mujori 2022. Këtu përfshihen fonde që janë deleguar nga qeverisja qendrore nëpërmjet ministrive të linjës për funksionet e deleguara për:

- Gjendjen Civile
- Qendrën Kombëtare të Biznesit
- Ndihmën Ekonomike
- Ndihmë për Personat me Aftësi të Kufizuar
- Kuota për shërbime të ndryshme sociale, Bursa
- Transferime
- Projekte të reja arsimore e kulturore

në lekë

	Emërtimi	Plan 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	%
01170	<i>Gjendja Civile</i>	46,780,675	35,129,000	34,484,376	74%
04130	<i>QKB</i>	4,090,000	2,666,000	1,915,136	47%
06190	<i>Strehimi</i>	400,301,000	400,301,000	199,910,000	50%
06220	<i>Menaxhimi i mbetjeve urbane</i>	180,000,000	180,000,000	179,722,265	100%
08230	<i>Arti dhe Kultura</i>	1,754,597,000	1,754,597,000	286,388,216	16%
09120	<i>Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	254,898,694	254,898,694	237,245,313	93%
09230	<i>Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	11,230,000	11,230,000	11,153,615	99%

09240	<i>Arsimi profesional</i>	19,746,945	19,746,945	13,251,022	0%
09450	<i>Arsimi Universitar</i>	500,000,000	500,000,000	-	0%
10430	<i>Kujdesi social për familjet dhe fëmijet</i>	2,215,462,520	1,796,405,520	1,730,757,549	78%
10910	<i>Emergjencia Civile</i>	333,158,750	333,158,750	-	0%
	TOTAL	5,720,265,584	5,288,132,909	2,694,827,492	47%

7. Fondi i Rezervës dhe Fondi i Kontigjencës

Fondi Rezervë për periudhën Janar – Gusht 2021, është përdorur si mëposhtë:

VKB nr.43 datë 12.05.2022 “Për Mbështetjen financiare në favor të federatës shqiptare të futbollit me qëllim realizimin e aktivitetit ndërkombëtar Europa Conference League Final, që mbahet në tiranë, më datë 25 maj 2022”, në shumën 41,183,500 lekë.

VKB nr.74 datë 26.07.2022 “Për Veprimtarinë e Klubit të Futbollit Tirana dhe mbështetjen financiare të tyre”, në shumën 5,500,000 lekë.

KAPITULLI II

*MONITORIMI

I

SHPENZIMEVE DHE PRODUKTEVE SIPAS PROGRAMEVE

1. Programi "Planifikim, Menaxhim & Administrim"

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 70%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 93%
- Shpenzime të tjera operative 53%
- Shpenzime kapitale 38%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,613,661,418	1,031,180,418	957,119,005	93%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	1,223,646,169	997,876,537	533,808,648	53%
<i>Shpenzime kapitale</i>	311,404,082	220,558,400	83,558,600	38%
Totali	3,148,711,669	2,249,615,355	1,574,486,253	70%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Shërbime të integruara sigurie për godinat, në institucionet e arsimit parashkollor e shkollor dhe institucione të tjera të Bashkisë Tiranë”, janë planifikuar 115,461,247 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 97,355,520 lekë ose 84.3% të planit 8-mujor 2022.
- Projekti “Marrje mjetesh rrugore me qera operationale (leasing) për Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 40,412,904 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 26,726,400 lekë, ose në masën 66.1% të planit 8-mujor 2022.
- Projekti “Subvencionimi i lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësave të ujit për kategorinë në nevojë”, janë planifikuar 5,000,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 2,422,918 lekë, ose 48.5% të planit.
- Kuota anëtarësimi në shoqata e unione janë planifikuar 20,000,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 18,829,053 lekë, ose në masën 94.1 % të planit 8-mujor 2022.
- Detyrime gjyqësore, janë planifikuar 153,178,349 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 77,847,152 lekë, ose 50.8 % të 8-mujorit 2022.
- Investimet për programin e Planifikim, Menaxhim, dhe Administrim për vitin 2022 janë rreth 29 projekte / investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim projektim; software, hardware, mirëmbajtje; të tjera) që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion realizuar në masën 37.9% të planit 8-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Rritja e transparencës dhe imazhit të Bashkisë Tiranë, kundrejt përthithjes së kandidatëve për t’u rekrutuar si nëpunës civilë dhe praktikantëve për të siguruar një edukim sa më të mirë të qytetarëve me tregun e punës dhe përfitimin e krahëve shtesë të forcës punëtore në Bashki në mënyrë eficiente. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Fillo me një ide, fito një praktikë pune në Bashkinë Tiranë” për 8-mujorin 2022 është planifikuar 5,000,000 lekë dhe është realizuar 35% e planit 8-mujor.

Produkti 2: Projekti "Apps -Challenge Tirana" për 8 mujorin 2022 është planifikuar 3,196,000 lekë dhe është realizuar 24.4% e planit 8- mujor ose 780,000 lekë.

2. Programi “Çështje Financiare & Fiskale”


Në këtë program bën pjesë - Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 krahasuar me buxhetin e periudhës është në masën 76%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 95% |
| - Shpenzime të tjera operative | 58% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	261,176,287	168,776,955	160,254,663	95%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	51,223,045	35,223,045	20,503,134	58%
<i>Shpenzime kapitale</i>	38,591,026	35,000,000	-	0%
Totali	350,990,358	239,000,000	180,757,797	76%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin 'Çështje Financiare & Fiskale për vitin 2022 janë 3 projekte / investime që menaxhohen nga Institucioni që mbulon këtë funksion, dhe për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim.

Objektivi për këtë program është: Të asistojë dhe të nxisë tatimpaguesit në mënyrë që të likuidojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor. Të sigurojë zgjerimin e bazës së taksueshme, rritja e numrit të taksapaguesve, dhe reduktimi i elementëve të evazionit. Për arritjen e këtij objektivi për 8-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Nxitja e respektimit vullnetar të legjislacionit tatimor nëpërmjet informimit për 63,609 tatim pagues aktivë janë shpenzuar 15,012,149 lekë nga 32,039,320 lekë të planifikuar për vitin 2022.

3. Programi “Shërbimet e Policisë Vendore”

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 79%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 90%
- Shpenzime të tjera operative 68%
- Shpenzime kapitale 6%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	524,694,186	335,249,847	301,955,173	90%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	50,550,153	40,550,153	27,527,820	68%
<i>Shpenzime kapitale</i>	46,720,000	46,720,000	2,577,939	6%
Totali	621,964,339	422,520,000	332,060,932	79%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Shërbimet e Policisë Vendore për vitin 2022 janë 7 projekte / investime që menaxhohen nga Institucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar

për këtë program është 46,720,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 6% e planit 8-mujor ose 2,577,939 lekë.

4. Programi “Mbrojtja nga Zjarri & Mbrojtja Civile”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Emergjencën Civile.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 24%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 65%
- Shpenzime të tjera operative 22%
- Shpenzime kapitale 2%
-

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	183,751,571	139,521,390	90,218,368	65%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	866,606,010	848,406,010	188,027,139	22%
<i>Shpenzime kapitale</i>	201,384,335	193,067,577	3,576,196	2%
Totali	1,251,741,916	1,180,994,977	281,821,703	24%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si mëposhtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Demolim dhe evadim i mbetjeve ndërtimore, në Bashkinë Tiranë”, janë planifikuar 3,211,664 lekë për 8-mujorin 2022, dhe realizim për këtë periudhë raportimi është 9% ose 292,692 lekë.
- Investimet për programin e Mbrojtjes Nga Zjarri dhe Mbrojtjes Civile për vitin 2022 përbëhet nga 15 projekte/investime të Emergjencës Civile dhe 5 projekte/investime të Mbrojtjes nga Zjarri që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion.

5. Programi “Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik”

Në këtë program bën pjesë - Aparati i Bashkisë,


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 25%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 25%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	39,000,000	39,000,000	9,852,337	25%
Totali	39,000,000	39,000,000	9,852,337	25%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për programin “Mbështetja per Zhvillimin Ekonomik” shpenzimet korente për 8-mujorin 2022 janë 3 projekte. Buxheti i planifikuar për këtë program është 39,000,000 lekë për 8-mujorin 2022.

- Projekti “Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”, janë planifikuar 6,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, nuk ka realizim për këtë periudhë.
- Projekti “Organizata jo-fitimprurese TID”, janë planifikuar 21,000,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar 4,352,337 lekë, ose në masën 20.7% të planit 8-mujor 2022.
- Projekti “Mbështetje financiare(Grant) për biznese të reja, “të gjelbërta” të cilat bazohen në një model eko-miqësor, ose biznese ekzistuese të cilat tentojnë të shndërrohen në biznese "të gjelbërta" duke futur elementë go-green në to”, janë planifikuar 12,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe për këtë projekt realizimi është në vlerë 5,500,000 lekë

6. Programi “Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi”

Ky program është në mbështetje të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së funksionimit të tregjeve në territorin e Bashkisë Tiranë dhe menaxhohet nga Agjencia e Administrimit të Tregjeve me burim nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 85%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 96%
- Shpenzime të tjera operative 93%
- Shpenzime kapitale 7%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	35,044,658	22,970,680	22,076,130	96%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	29,176,000	21,076,000	19,500,647	93%
<i>Shpenzime kapitale</i>	5,183,840	5,183,840	364,368	7%
Totali	69,404,498	49,230,520	41,941,145	85%

Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin Shërbimi i Tregjeve, Akreditimi & Inspektimi për vitin 2022 përbëhet nga 3 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 5,183,840 lekë për 8-mujorin 2022, për të cilat ka realizim në vlerën 364,368 lekë ose 7%.



7. Programi “Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve”


Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 65%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 92%
- Shpenzime të tjera operative 41%
- Shpenzime kapitale 0%
-

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	174,665,885	112,000,000	102,573,347	92%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	92,282,194	66,188,414	26,931,672	41%
<i>Shpenzime kapitale</i>	20,927,800	20,927,800	-	0%
Totali	287,875,879	199,116,214	129,505,019	65%



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti "Hartimi i planeve të mbarështimit të fondit pyjor dhe kullosor për Ekonominë Pyjore "Pezë", Ekonominë Pyjore "Shesh" dhe Ekonominë Pyjore "Krrabë-Gurrë, janë planifikuar 14,072,414 lekë për 8-mujorin 2022, i cili është realizuar 100%.
- Projekti "Hartimi i planit të mbarështimit të ekonomisë pyjore "Zall-Herr-Priskë" janë planifikuar 6,116,000 lekë për 8-mujorin 2022 për të cilin nuk ka realizim.
- Projekti "Përditësim i "Regjistrimit të fermerëve" për NjA Baldushk janë planifikuar 5,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, për të cilin nuk ka realizim.
- Investimet për programin e Shërbimeve bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve për vitin 2022 përbëhet nga 7 projekte/investime që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 20,927,800 lekë për 8-mujorin 2022, për të cilat nuk ka realizim për këtë periudhë.

Objektivi i këtij programi është: Inspektimi dhe shërbimet për qytetarët, administrim i thertoresh publike si dhe mbrojtja e trajtimi i kafshëve endacake. Për arritjen e këtij objektivi për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të tjera janë realizuar 13,942 kontrolle dhe inspektime përgjatë kësaj periudhe raportimi nga 18,000 kontrolle dhe inspektime të planifikuara për vitin 2022.

Produkti 2: Trajtimi i ankesave të qytetarëve janë trajtuar 849 ankesa, shpenzimet deri tani janë 16,907,564 lekë nga 47,133,177 lekë të planifikuara për vitin 2022.

8. Programi “Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit”


Ky program menaxhohet nga Aparati Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik (Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale)

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 78%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 78%
 - Shpenzime kapitale 0%
- në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	24,181,178	19,229,833	14,933,138	78%
<i>Shpenzime kapitale</i>	95,279,293	95,279,293	-	0%
Totali	119,460,471	114,509,126	14,933,138	13%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Shpenzime operative të menaxhuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik janë planifikuar 19,229,833 lekë për 8-mujorin 2022 dhe realizuar në masën 78% të planit 8-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e çdo sistemi kullimi dhe vepër mbrojtjeje nga përmbytja brenda zonës përkatëse në mënyrë që të largojë ujin e tepërt dhe të parandalojë grumbullimin e ujit, zhvillimin e kripëzimit dhe toksifikimit, dhe të parandalojë përmbytjen. Pastron dhe mirëmban kanalet kulluese, mbledhëse, tubat dhe strukturat; Shfrytëzon dhe mirëmban stacionet e pompave të kullimit dhe hodrovoret; kontrollon cilësinë e ujit si dhe mbikqyrë, mirëmban dhe rregullon sistemet kryesore të kullimit dhe veprat e mbrojtjes nga përmbytja. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me ujitje nga 6,340 (ha) nga të cilat janë realizuar për 3,452 (ha) ose 6,606,504 lekë.

Produkti 2: Sipërfaqe bujqësore e mbuluar me kullim nga 2450 (ha) të planifikuar janë realizuar për 1,135 (ha) në total shpenzimet për këtë produkt për 8-mujorin 2022 janë në vlerën 4,405,654 lekë.


9. Programi “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave”

Ky program menaxhohet nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit me fonde nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 68%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 68%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	në lekë
				Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	11,758,002	9,480,284	6,464,500	68%
Totali	11,758,002	9,480,284	6,464,500	68%



10. Programi “Rrjeti Rrugor”


Ky program është në funksion të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve në zonat urbane dhe rurale. Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë si dhe Insitucioni i varësisë Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 30%.

Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 96%
- Shpenzime të tjera operative 57%
- Shpenzime kapitale 15%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	në lekë
				Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	374,740,237	239,087,797	229,365,991	96%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	640,257,956	428,591,543	243,446,341	57%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,363,018,056	1,806,457,748	268,143,854	15%
Totali	3,378,016,249	2,474,137,088	740,956,186	30%



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Menaxhimi dhe mirëmbajtja e sheshit Skënderbej”, është planifikuar 36,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 33,738,159 lekë, ose në masën 93.7% të planit 8-mujor të vitit 2022.
- Projekti i mirëmbajtjes vjetore dhe asistencës teknike të Qendrës së Monitorimit e Menaxhimit të Sistemeve të Transportit, është planifikuar 8,652,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në masën 100% të planit 8-mujor të vitit 2022.
- Investimet për programin Rrjeti Rrugor për vitin 2022 janë rreth 99 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga institucionet që mbulojnë këtë funksion, nga të cilat rikonstruksione, ndërhyrje rehabilituese dhe ndërtime, janë kryer në masën 15% të 8-mujorit të vitit 2022.

Objektivi i këtij programi është: Mirëmbajtja e rrugëve kryesore dhe jokryesore me asfaltobeton (sistemim, asfaltim i pjesshëm), mirëmbajtja e trotuareve dhe shesheve publike (sistemime të pjesshme me pllaka, asfalt dhe beton), mirëmbajtja dhe pastrimi i zgavrave dhe kënetave të ujërave të bardha (disiplinimi i ujërave të shiut), fuqizimi dhe modernizimi i ndriçimit publik dhe mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i rrjetit të semaforëve dhe sinjalistikës rrugore. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Rrugë të mirëmbajtura në vit, asfalt nga 98,600 m² të planifikuara janë realizuar 72,282 m² për 8-mujorin 2022.

Produkti 2: Rrugë të mirëmbajtura në vit, troturare nga 23,000 m² të planifikuara janë realizuar 10,349 m² për 8-mujorin 2022.

Produkti 3: Pajisje me sinjalistikë horizontale janë planifikuar rreth 2,325 copë kangjella, birila, grerëza për tu vendosur gjatë këtij viti, për 4-mujorin e dytë janë vendosur në total 955 copë kangjella, birila, grerëza ose 5,404,196 lekë të shpenzuar për këtë produkt. Për vijëzimet e rrugëve për 8-mujorin 2022 në total janë realizuar 13,150,000 lekë.

11. Programi “Transporti Publik”

Në këtë program bën pjesë Aparati i Bashkisë si dhe Tirana Parking si institucion varësie.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 38%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 86%
- Shpenzime të tjera operative 37%
- Shpenzime kapitale 23%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	117,243,774	74,924,000	64,490,566	86%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	245,576,000	213,576,000	80,016,298	37%
<i>Shpenzime kapitale</i>	225,837,811	225,837,811	51,521,206	23%
Totali	588,657,585	514,337,811	196,028,070	38%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Transportit Publik për vitin 2022 janë rreth 18 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikëqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 225,837,811 lekë për 8-mujorin 2022, realizuar në masën 23% të planit 8-mujor 2022.

Objektivi 1 i këtij programi është: Grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Subvencion për shërbimin e transportit qytetas në Bashkinë e Tiranës është një projekt. Plani i planifikuar është në vlerën 136,000,000 lekë nga të cilat janë realizuar 48,814,002 lekë ose 36% e vlerës së planit.

Produkti 2: Matjet periodike të pasagjerëve të transportit publik qytetas është një projekt. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 3,000,000 lekë, për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim.

Produkti 3: Projekti i GPS në Transportin Publik të qytetit është një projekt. Plani i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 22,500,000 lekë, për këtë periudhë raportimi nuk ka realizim për këtë produkt.

Objektivi 2 i këtij programi është: Shtimi i blloqeve rezident në qytetin e Tiranës me qëllim rritjen e kapaciteteve të parkimit të qytetarëve. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produkte me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mirëmbajtja e sipërfaqeve të shesheve të parkimit në total gjatë viti 2022 janë 51829 m² të cilat do të mirëmbahen nga institucioni i varësisë Tirana Parking. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 183,092,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 50% të vlerës ose në vlerën 91,212,060 lekë.

Produkti 2: Mirëmbajtja e sistemeve të parkimeve dhe pastrimi, buxheti për vitin 2022 është në vlerën 18,228,000 lekë, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 25% ose në vlerën 4,480,810 lekë.

12. Programi “Projekte Zhvillimi”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.


Gjatë 8-mujorit 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 38%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 61%
- Shpenzime kapitale 32%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	43,656,317	43,656,317	26,810,647	61%
<i>Shpenzime kapitale</i>	281,343,218	189,009,698	61,052,883	32%
Totali	324,999,535	232,666,015	87,863,530	38%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Investimet për programin “Projektet e Zhvillimit” për vitin 2022 janë 14 projekte/investime që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 439,872,338.5 lekë për vitin 2022, i cili është realizuar në masën 14% ose në vlerën 61,052,883 lekë.

13. Programi “Zhvillimi i Turizmit”


Në këtë program përfshihen projekte për zhvillimin e turizmit nga Aparati i Bashkisë.

Gjate 8-mujorit 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 71%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 71%

Shpenzimet sipas klasifikimit	në lekë			
	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	20,152,950	16,152,950	11,508,550	71%
Totali	20,152,950	16,152,950	11,508,550	71%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden Projekte Turizmi, buxheti i të cilës është planifikuar 16,152,950 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 11,508,550 lekë, ose në masën 71% të periudhës së raportimit.

14. Programi “Menaxhim i Mbetjeve”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 80%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 80%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	2,085,858,518	1,738,698,518	1,396,242,687	80%
Totali	2,085,858,518	1,738,698,518	1,396,242,687	80%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Pastrimi i Qytetit, është planifikuar 1,282,383,356 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 961,428,001 lekë, ose në masën 75% të planit 8-mujor të vitit 2022.
- Shpenzime për Ndërtimin e Landfillit, Inceneratorit dhe Rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike që është edhe në funksion të zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës vendore rajonale, është planifikuar 456,315,162 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 434,814,686 lekë, ose në masën 95% të planit 8-mujor të vitit 2022.

15. Programi “Programet e Mbrojtjes së Mjedisit”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 48%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 48%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	9,837,947	7,837,947	3,782,296	48%
Totali	9,837,947	7,837,947	3,782,296	48%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Mjedisore, është planifikuar 4,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, për të cilën nuk ka realizim.
- Hartimi i Planit të Veprimit mbi zhurmat për Bashkinë Tiranë, është planifikuar 3,837,947 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 3,782,296 lekë, ose në masën 98.5% të planit 8-mujor të vitit 2022.

16. Programi “Planifikimi Urban Vendor”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit. Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 24%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 92%
- Shpenzime të tjera operative 10%
- Shpenzime kapitale 22%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personell</i>	169,884,000	110,000,000	100,975,486	92%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	35,409,500	26,609,500	2,671,722	10%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,767,431,585	3,301,006,583	726,889,929	22%
Totali	3,972,725,085	3,437,616,083	830,537,137	24%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti 1 i këtij programi është: Harmonizimi i interesave publike dhe interesave private që do të rezultojë në mbrojtjen e hapësirave publike dhe atyre të gjelbërta. Planifikimin e objekteve të shpronësuara si rezultat i ndërtimit të veprave madhore nga Bashkia e Tiranës bazuar në legjislacionin përkatës. Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetarët; Hartimin e planeve të detajuara vendore për zberthimin e planit përgjithshëm vendor dhe kontrollit të zhvillimit të vazhdueshëm të hapësirave urbane të qytetit, duke bërë kështu që objekti i shpronësimit të jetë parësor në këtë program:

Investimet për programin e Planifikimit Urban Vendor për vitin 2022 janë 67 projekte /shpronësime dhe studime që menaxhohen nga Aparati i Bashkisë që mbulon këtë funksion nga të cilat janë realizuar 22 % të planit për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 2 i këtij programi është: Inspektimi dhe kontrolli i subjekteve ndërtuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Numri i inspektimeve tek të tretët (subjekte private dhe publike) për vitin 2022 janë planifikuar rreth 900 inspektime nga të cilat janë realizuar 306 inspektime për 8-mujorin e vitit 2022.


17. Programi “Programet e Zhvillimit”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 për këtë funksion, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 63%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 49%
- Shpenzime kapitale 63%

në lekë				
Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	84,165,715	78,165,715	38,508,941	49%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,825,765,893	2,825,765,893	1,792,852,380	63%
Totali	2,909,931,608	2,903,931,608	1,831,361,321	63%



Objekti i këtij programi është: Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe asamblesë së bashkëpronarëve për krijimin e një skeme efektive bashkë-financimi për përmirësimin e ambienteve në pronësi të përbashkët. Për 8-mujorin 2022 vlen të përmendet ky produkt i programit i cili zë një peshë specifike në këtë funksion:

Produkti 1: Projekti “Fondi i Komuniteteve, është planifikuar 64,165,715 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 38,508,941 lekë, ose në masën 60% të planit 8-mujor të vitit 2022.

18. Programi ‘Shërbime Publike Vendore’

Në këtë program bëjnë pjesë Institucionet e varësisë si më poshtë:

- Aparati i Bashkisë
- Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjelbërimit
- Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- Agjencia e Shërbimeve Funerale

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022 për këtë funksion krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 30%.


Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime personeli 87%
- Shpenzime të tjera operative 68%
- Shpenzime kapitale 14%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	857,257,795	546,029,235	475,857,985	87%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	552,234,069	378,234,069	257,405,172	68%
<i>Shpenzime kapitale</i>	3,972,620,162	2,856,623,414	392,068,532	14%
Totali	5,382,112,026	3,780,886,718	1,125,331,689	30%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Shërbimeve Publike Vendore për vitin 2022 janë rreth 134 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion, realizuar në masën 14% për këtë periudhë raportimi.

Objektivi 1 i këtij programi është: Shtimi i ambienteve shlodhëse, argëtuese dhe terreneve sportive; rikonstruksion i objekteve rekreative, sanitare, info-point, objekteve të shërbimit në parqe; rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbërta egzistuese. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe e gjelbëruar në vit (zgjerimi i hapësirave të gjelbra) m² gjatë 4-mujorit të dytë janë shtuar 18,980 m² nga 40,000 m² të planifikuara për vitin 2022.

Produkti 2: Rrënjë peme të mbjella për 4-mujorin e dytë të vitit janë mbjellur 15,986 rrënjë nga 30,000 rrënjë të planifikuara për vitin 2022.

Produkti 3: Numri i punonjësve në shërbim të aktiviteteve, kënde lojrash rekreative dhe fushat sportive janë planifikuar për këtë vit 105 punonjës ose 65 punonjës më shumë se viti i kaluar. Ky numër është rritur nga shtimi i aktiviteteve në Tiranë, shtimi i këndeve të lojrave si dhe fushat sportive, aktualisht janë 105 punonjës, dhe si rezultat viti ka patur rritje nga plani fillestar. Për shkak të shtimit të shesheve rekreative është krijuar Drejtoria e Sporteve, Drejtoria e Zoo Parkut.

Objektivi 2 i këtij programi është: Administrimi dhe organizimi i shërbimeve funerale, pastrimi mirëmbajtja dhe ruajtja e varrezave publike. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sipërfaqe për mirëmbajtjen totale të varrezave në total janë 502,070 m², sipërfaqe të cilat duhen të mirëmbahen gjatë viti 2022, buxheti i planifikuar për këtë produkt për vitin 2022 është 161,924,115 lek, për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 47% ose 75,850,340 lekë

19. Programi “Ndriçim Rrugësh”


Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 53%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 53%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	384,867,082	330,867,082	174,202,031	53%
Totali	384,867,082	330,867,082	174,202,031	53%



Objekti i këtij programi është mirëmbajtja dhe ndriçimi i rrugëve dhe ambienteve publike në territorin e Bashkisë Tiranë. Për arritjen e këtij objekti, për 8-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Sheshe publike të ndriçuara janë planifikuar 7,072 m² sheshe për vitin 2022, për këtë periudhë raportimi sipërfaqja e shesheve të ndriçuara është 1,673 m².

20. Programi “Sport dhe Argëtim”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Insitucionet e varësisë si më poshtë:


- Agjencia e Rinisë
- Klubi Sportiv “Tirana”
- Klubi shumësportësh “Partizani”
- Klubi Sportiv “Studenti”

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 69%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 85% |
| - Shpenzime të tjera operative | 69% |
| - Shpenzime kapitale | 39% |

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	74,511,653	51,401,575	43,498,276	85%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	360,175,992	314,251,992	215,908,573	69%
<i>Shpenzime kapitale</i>	26,715,598	26,715,598	10,539,095	39%
Totali	461,403,243	392,369,165	269,945,944	69%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Ky program është në funksion të krijimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave sportive dhe organizimit të aktiviteteve për rininë.

Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Rinore janë planifikuar 12,791,700 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 3,491,700 lekë, ose realizuar në masën 27 % të planit 8-mujor 2022.
- Projekte Sportive janë planifikuar 15,000,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 13,242,795 lekë, ose në masën 88% të planit.
- Projekti “Tirana Youth Capital” është planifikuar 100,000,000 lekë për vitin 2022 dhe është realizuar në vlerën 50,000,000 lekë, ose realizuar në masën 50% të planit. Ky projekt paraqitet si një makro program dhe mundësi fantastike që do të zgjasë 365 ditë, gjatë të cilave do i jepet jetë një kalendari projektësh me iniciativa e aktivitete të shumta, të cilat do të mbulojnë një

gamë të gjerë tematikash e prioritetesh që kanë në qendër rininë, në nivel kombëtar, rajonal dhe europian.

- Investimet për programin Sport dhe Argëtim për vitin 2022 janë rreth 6 projekte/investime që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion të realizuara 39% gjatë kësaj periudhe raportimi.

21. Programi "Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore"

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Insitucionet e varësisë si më poshtë:


- Qendra Rinore TEN
- Qendra Kulturore Tirana
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Kadare"
- Qendra e Restaurimit dhe Realizimit të Veprave të Artit Tiranë
- Muzeu Vendor "Shtëpia Studio Agolli"
- Galeria e Artit Tirana
- Agjensia e Industrisë Kreative

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 64%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|-----|
| - Shpenzimet e personelit | 91% |
| - Shpenzime të tjera operative | 72% |
| - Shpenzime kapitale | 3% |

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	109,163,283	70,046,100	63,648,251	91%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	526,438,400	475,238,400	341,355,030	72%
<i>Shpenzime kapitale</i>	96,110,556	96,110,556	3,112,560	3%
Totali	731,712,239	641,395,056	408,115,841	64%



Ky program është në funksion të krijimit, funksionimit dhe mirëmbajtjes së projekteve/ambienteve kulturore dhe artistike. Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekte Kulturore janë planifikuar 203,728,252 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 156,370,889 lekë, ose realizuar në masën 77% të planit të periudhës raportuese.
- Shërbimi i Dekorit të Qytetit, janë planifikuar 123,257,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 58,013,024 lekë, ose realizuar në masën 47 % të planit 8-mujor 2022.
- Investimet për programin e Trashëgimisë Kulturore, Eventet artistike dhe kulturore për vitin 2022 janë rreth 28 projekte/investime që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti i planifikuar për këtë program është 96,110,556 lekë për vitin 2022, për të cilën realizimi është 3%.

22. Programi “Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Institucionet e varësisë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve,
- Shkolla “Luigj Gurakuqi”.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 44%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 76%
- Shpenzime të tjera operative 77%
- Shpenzime kapitale 21%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	1,551,051,027	1,104,711,835	842,498,396	76%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	623,100,456	387,468,456	299,422,278	77%
<i>Shpenzime kapitale</i>	2,096,902,093	2,059,955,155	437,248,270	21%
Totali	4,271,053,576	3,552,135,446	1,579,168,944	44%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor për vitin 2022 janë rreth 64 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponentë teknike; të tjera) që menaxhohen nga insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Buxheti

i planifikuar për investimet për këtë program është 2,096,902,093 lekë për vitin 2022, të cilat janë realizuar në vlerën 437,248,270 lekë ose në masën 21% të planit 8-mujor të vitit 2022.

23. Programi “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike


Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 65%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 77%
- Shpenzime të tjera operative 72%
- Shpenzime kapitale 54%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	643,262,187	455,467,779	349,052,177	77%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	557,528,051	390,528,051	282,835,976	72%
<i>Shpenzime kapitale</i>	795,447,839	730,819,704	395,712,485	54%
Totali	1,996,238,077	1,576,815,534	1,027,600,638	65%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Investimet për programin e Arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2022 janë rreth 38 projekte/investime (ndërtim-montim; mbikqyrje; kolaudim; studim-projektim; oponencë teknike; të tjera) që menaxhohen nga Insitucionet që mbulojnë këtë funksion. Për këtë periudhë raportimi është realizuar në masën 54% të planit 8-mujor 2022.

Objektivi i këtij programi është: Mirëmbajtje e ambienteve në objektet arsimore parauniversitare mirëmbajtjen, lyerjen, pastrimin e grafiteve të paautorizuara, shkarravinave me përmbajtje anti-kulturore, figurave, reklamave apo ngjitjeve me materiale të ndryshme në sipërfaqet e mbikalimeve, nënkalimeve përfshirë kolonat mbajtëse, muret rrethuese që përbëjnë pjesë të arkitekturës urbanistike, platformat ku janë vendosur monumente artistike, konstruksionet e shatërvaneve, si dhe çdo sipërfaqe tjetër ndërtimore e aksesit publik. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para-universitare sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 270,200 m², buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 401,100,900 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 189,254 m² dhe është shpenzuar 272,116,000 lekë.

Produkti 2: Mirëmbajtje e objekteve arsimore para-shkolllore sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 50,181 m², buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 68,147,000 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 16,830 m² dhe është shpenzuar 39,192,000 lekë.

Produkti 3: Mirëmbajtje e objekteve të tjera publike sipërfaqja totale për t'u mirëmbajtur gjatë vitit 2022 është 48,550 m², buxheti i planifikuar për këtë produkt është në vlerën 62,701,180 lekë, për këtë periudhë raportimi janë mirëmbajtur 16,385 m² dhe është shpenzuar 37,680,000 lekë.


24. Programi "Arsimi Profesional"

Në këtë program bën pjesë Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme si institucion varësie.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 42%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 66%
 - Shpenzime të tjera operative 44%
 - Shpenzime kapitale 4%
- në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	103,532,626	78,790,600	52,149,069	66%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	24,879,128	19,979,433	8,722,882	44%
<i>Shpenzime kapitale</i>	50,269,550	50,269,550	1,912,800	4%
Totali	178,681,304	149,039,583	62,784,751	42%



Objektivi i këtij programi është: Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve të arsimit profesional (vetëm konviktet). Për arritjen e këtij objekti, për 8-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti: Numri i nxënësve të akomoduar në konvikte janë 254 nxënës për këtë 8-mujor të vitit 2022. Për këtë vit janë planifikuar të akomodohen 300 nxënës, buxheti i shpenzuar është në vlerën 60,871,951 lekë nga 128,411,754 lekë të planifikuar.

25. Programi “Kujdesi Social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuar

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 13%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 13%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	17,070,000	12,000,000	1,582,350	13%
Totali	17,070,000	12,000,000	1,582,350	13%



Objektivi për këtë program është: Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor. Për arritjen e këtij objekti, për 8-mujorin 2022, është realizuar produkti me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Komisione për pagesa NE+PAK” janë planifikuar 12,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 1,582,350 lekë, ose në masën 13% të planit 8-mujor 2022.

26. Programi “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”

Në këtë program bëjnë pjesë Aparati i Bashkisë dhe institucionet e varësisë si më poshtë:

- Qendra Sociale Multidisiplinare
- Qendra Komunitare “Shkozë”
- Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”
- Qendra Komunitare “Strehëza”
- Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhiu”
- Qendra Komunitare e Terrenit

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 48%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:


- Shpenzimet e personelit 84%

- Shpenzime të tjera operative 25%
- Shpenzime kapitale 61%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime personeli</i>	132,381,206	85,761,851	72,331,854	84%
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	162,990,233	135,500,153	33,561,739	25%
<i>Shpenzime kapitale</i>	7,098,459	7,098,459	4,354,384	61%
Totali	302,469,898	228,360,463	110,247,977	48%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Për 8-mujorin 2022 vlen të përmenden këto produkte të programit të cilët zënë një peshë specifike në këtë funksion:

- Projekti “Mbështetje Sociale në Shërbime për kategoritë në nevojë” janë planifikuar 27,053,014 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 970,002 lekë, ose në masën 4% të planit të periudhës së raportimit.
- Ndihma Ekonomike / Paaftësia janë planifikuar 1,990,029,000 lekë për buxhetin e vitit 2022, dhe është realizuar në vlerën 1,578,300,413 lekë, ose në masën 98% të planit (transferta e kushtëzuar).
- Projekti “Mbrojtja Sociale për kategorinë e familjeve në nevojë të përjashtuara nga skema e NE-së” janë planifikuar 6,000,000 lekë për 8-mujorin 2022 dhe është realizuar në vlerën 3,931,142 lekë, ose në masën 66% të planit të periudhës së raportimit.

- Investimet për programin e Kujdesit Social për Familjet dhe Fëmijët për vitin 2022 janë 16 projekte/investime që menaxhohen nga institucionet që mbulojnë këtë funksion dhe janë realizuar në masën 61% të planit 8-mujor të vitit 2022.

Objektivi për këtë program është: Mbështetje sociale, psiko- mediko-emocionale, ligjore, edukative për fëmijët dhe familjet në nevojë, të komuniteteve të ndryshme, shërbimin e mencës, aktivitete të ndryshme për të gjithë llojet e shtresave në nevojë. Për arritjen e këtij objekti, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në kamp veror me qëllim zhvillimin e aftësive për jetën dhe parandalimin e sjelljeve të rrezikshme. Shërbimi aktualisht ju ofrohet 50 personave. Buxheti i planifikuar për këtë vit është në vlerën 679,867 lekë për të cilat janë shpenzuar 57% e vlerës. Nga viti i kaluar kemi një rritje me 25% të fëmijëve dhe të rinjve që ofrohet ky shërbim.

Produkti 2: Numri i personave në situatë rruge të trajtuara janë 323 persona (fëmijë dhe të rritur) buxheti i planifikuar 4,391,943 lekë nga të cilat janë shpenzuar 2,357,468 lekë për këtë periudhë raportimi.

Produkti 3: Numri i fëmijëve dhe të rinjve me Aftësi të Kufizuar që përfitojnë të gjitha shërbimet ditore pa përfshirë mencën për vitin 2022 është planifikuar t'ju ofrohet 65 personave nga të cilët për këtë periudhë raportimi e kanë marrë si shërbim 63 persona.


27. Programi “Papunësia, Arsim dhe Aftësim Profesional”

Në këtë program përfshihen projekte që zhvillohen nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 40%. Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 40%

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	në lekë
				Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	35,000,000	35,000,000	14,150,000	40%
Totali	35,000,000	35,000,000	14,150,000	40%



Objektivi 1 është: Fuqizimi ekonomik i grave dhe të rejave të cilat me hapjen dhe zgjerimin e bizneseve të vogla nëpërmjet granteve, zgjedhin të zhvillojnë idetë e tyre inovatore në biznes që gjenerojnë vetëpunësim dhe rritjen e numrit të të punësuarve. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes”, është planifikuar 20,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 5,750,000 lekë.

Objektivi 2 është: Krijimi i lehtësirave për hapjen e vendeve të reja të punës për të rinj të sapo diplomuar pa eksperiencë pune të cilët kanë pritshmëri punësimi dhe integrimi në tregun e punës; Nxitjen e punësimit të biznesit rinor, nëpërmjet lehtësirave në ngritjen e biznesit të vogël. Për arritjen e këtij objektivi, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti "Projekti i fuqizimit të të rinjve dhe të rejave", është planifikuar 15,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 8,400,000 lekë për këtë periudhë raportimi.

28. Programi “Strehimi Social”

Ky program menaxhohet nga Aparati i Bashkisë.

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin 2022, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në masën 75%.


Sipas klasifikimit ekonomik kjo shpërndarje rezulton si më poshtë:

- Shpenzime të tjera operative 75%
- Shpenzime kapitale 0%

në lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Plani 2022	Plani 8M 2022	Fakti 8M 2022	Realizimi në %
<i>Shpenzime të tjera operative</i>	355,799,206	355,799,206	267,699,817	75%
<i>Shpenzime kapitale</i>	1,086,847,184	-	-	0%
Totali	1,442,646,390	355,799,206	267,699,817	75%

Grafikisht, realizimi i shpenzimeve në program sipas klasifikimit ekonomik paraqitet si më poshtë:



Objekti i programeve sociale të strehimit është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Për arritjen e këtij objekti, për 8-mujorin 2022, janë realizuar produktet me të dhënat si vijon:

Produkti 1: Projekti “Bonus Strehimi”, është planifikuar 250,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 229,091,451.39 lekë, ose në masën 92% të planit 8-mujor të vitit 2022.

Produkti 2: Projekti "Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë për familjet që preken nga zbatimi i projektit të rehabilitimit të segmentit Komuna e Parisit-Rr.Kavajes, është planifikuar në vlerën 13,999,206 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 12,226,716 lekë.

Produkti 3: Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë (në kuadër të rindërtimit) për familjet që preken nga zbatimi i projektit "Rehabilitimi i lagjes 5 Maji", është planifikuar në vlerën 20,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 8,326,000 lekë.

Produkti 4: Bonus Strehimi për trajtimin me pagesë të qirasë (në kuadër të rindërtimit) për familjet që preken nga zbatimi i projektit "Rindërtimi në Kombinat" është planifikuar në vlerën 20,000,000 lekë për 8-mujorin 2022, dhe është realizuar në vlerën 17,733,000 lekë.

KAPITULLI III

ECURIA

E


BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITET 2018-2022

Trendi i kryerjes së shpenzimeve të buxhetit ndër vite paraqitet si më poshte, në bazë të klasifikimit ekonomik dhe me të gjitha burimet e financimit në Bashkinë Tiranë:

lekë

Shpenzimet sipas klasifikimit	Fakti 8M 2018	Fakti 8M 2019	Fakti 8M 2020	Fakti 8M 2021	Fakti 8M 2022
<i>Shpenzime personeli</i>	3,056,257,178	3,344,944,732	3,528,344,710	3,861,226,509	3,964,414,249
<i>Shpenzime te tjera operative</i>	5,443,227,510	5,907,609,434	6,460,905,059	7,048,347,618	6,909,167,178
<i>Shpenzime kapitale</i>	4,858,831,594	4,903,225,953	3,142,207,780	4,976,962,564	4,532,178,648
Totali	13,358,316,282	14,155,780,119	13,131,457,549	15,886,536,691	15,405,760,075

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:



Klasifikimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit vitet 2018 - 2022

Shpenzimet sipas burimeve të financimit	Fakti 8M 2018	Fakti 8M 2019	Fakti 8M 2020	Fakti 8M 2021	Fakti 8M 2022
<i>Të ardhura BT</i>	8,470,624,710	9,122,300,048	7,975,994,876	7,227,717,059	7,191,260,927
<i>Transferta e Pakushtëzuar e përgjithshme dhe specifike</i>	2,204,774,743	2,677,345,552	2,190,835,469	2,038,078,394	2,742,741,705
<i>Transferta e Pakushtëzuar /Rindertimi</i>			147,979,120	3,863,600,296	2,770,761,039
<i>Transferta e Kushtëzuar</i>	2,681,672,838	2,353,039,154	2,810,426,172	2,727,453,419	2,694,827,492
<i>Donacione</i>	1,243,991	3,095,365	6,221,912	27,393,813	3,296,711
<i>Financimet e Huaja</i>				2,293,710	-
<i>TVSH Detyrimi</i>					2,872,201
Totali	13,358,316,282	14,155,780,119	13,131,457,549	15,886,536,691	15,405,760,075

Si dhe paraqitjen grafike të tyre:

